



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË

KABINETI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2012

Lënda : Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë per 3 mujorin 2012.

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE**

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË BUXHETIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 10296 datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjit Nr.10487 date 5.12.2011 "Per buxhetin e vitit 2012", ne zbatim te Udhezimit Nr. 2/1 date 15.2.2012 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012" bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për realizimin e buxhetit të tremujorit te pare te vitit 2012.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARE E PERGJITHSHME

MIRELA CANO

Raporti i monitorimit per Ministrine e Shendetesise per tremujorin e pare te vitit 2012

Ministria e Shendetesise , per vitin 2012, administron dhe menaxhon fondet publike sipas kater programeve te miratuara, si vijon:

1. Planifikim menaxhim administrim
2. Sherbime te kujdesit shendetesor paresor
3. Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor
4. Sherbime te shendetit publik

Realizimi i shpenzimeve te buxhetit per tremujorin e pare te vitit 2012, paraqitet si me poshte vijon:

| Titulli | Emri i Programit | Buxheti 2012 ne mije leke | Fakti 2012 ne mije leke | % e realizimit 2012 | Struktura ne % fakti 3 mujori 2012 |
|---|--|--------------------------------------|------------------------------------|--------------------------------|---|
| 0110 | Planifikim Menaxhim Administrim | 226.780 | 63.339 | 28 | 0.7 |
| 07220 | Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor | 17.065.491 | 4.820.334 | 30 | 52 |
| 07330 | Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor | 16.416.568 | 3.913.184 | 24 | 42 |
| 07450 | Sherbime te Shendetit Publik | 2.501.569 | 492.268 | 19 | 5.3 |
| | | | | | |
| Totali i shpenzimeve te ministrise | | 35.550.408 | 9.289.125 | 26 | 100 |

Struktura e shpenzimeve sipas programeve paraqitet si me poshte vijon:

Ne
perqindje

| Titulli | Emri i Programit | PBA Plan 2012 | Budget 2012 | Fakti 2012 |
|----------------|--|--------------------------|------------------------|-----------------------|
| 0110 | Planifikim Menaxhim Administrim | 0.7 | 0.6 | 0.7 |
| 07220 | Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor | 45.4 | 46.1 | 52 |

| | | | | |
|---------------|--|-------|-------|-------|
| O7330 | Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor | 46.7 | 46.2 | 42 |
| O7450 | Sherbime te Shendetit Publik | 7.2 | 7.1 | 5.3 |
| Totali | | 100.0 | 100.0 | 100.0 |

Rreth 0.7% te totalit te shpenzimeve faktike eshte perdorur per programin planifikim menaxhim administrim. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor paresor eshte perdorur 52%. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor dytesor eshte perdorur po ashtu rreth 42%, ndersa per programin sherbime te shendetit publik eshte perdorur rreth 5,3% te totalit te fondeve te perdorura.

Me poshte po paraqesim nje analize te detajuar te treguesve te monitorimit te buxhetit sipas programeve buxhetore.

1. Programi Planifikim Menaxhim Administrim

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Arritja 100% e angazhimeve kombetare dhe nderkombetare.
- Plotesimi 100% i angazhimeve ligjore ne fushen e shendetesise sipas matrices se projekt akteve per vitin 2012.
- Zbatimi i planit te perafrimit te legjislacionit 2012-2015.

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 0.7% te totalit te shpenzimeve te kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente 28%

Shpenzime kapitale 16%

Ne kete program jane parashikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Ne mije leke

| | Buxheti | Fakti | Statusi i realizimit |
|----------------------------------|----------------|--------------|-----------------------------|
| Emri i Produktit | 2012 | 2012 | 3M I |
| Menaxhimi i politikës sektoriale | 223,400 | 62,787 | plotesisht |
| Blerje pajisje mobilimi , zyre | 2,380 | 0 | aspak |

| | | | |
|---|-------|-----|------------|
| e kompjuterike | | | |
| Projekte te mbeshtetura me detyrim doganor e kosto lokale | 1,000 | 552 | pjeserisht |

Ne kete program per produktin “Blerje pajisje mobilimi, zyre e kompiuterike” jemi ne fazen e kryerjes se procedurave te tenderimit te perqendruar nga ana e Ministrise se Brendshme.

2. Programi sherbime te kujdesit shendetesor paresor

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Permiresim i ofrimit te sherbimit paresor nepermjet zgjerimit te skemes se medikamenteve nga 420 qe ishin ne 2011, ne 430 barna ne vitin 2012.
- Zvogelim i vdekshmerise foshnjore ne vitin 2012 me 0.5 per 1000 krahasuar me vitin 2011
- Zvogelim i vdekshmerise amtare me 1/100000 ne vitin 2012 krahasuar me 16 per 100000 qe eshte ne vitin 2010.
- Rritja e vizitave/kontakteve te pacientit ne kujdesin paresor ne 10 vizita/dite/mjek ne vitin 2012 nga 9 ne vitin 2011
- Plotesim ne masen 45% te standarteve te infrastruktures krahasuar me 42% qe realizohen ne 2011

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 52% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente 33%

Shpenzime kapitale 1%

Ne kete program jane parashikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

| | Buxheti | Fakti | Statusi i realizimit |
|---|-----------|-----------|----------------------|
| Emri i Produktit | 2012 | 2012 | 3M I |
| Sigurimi i mbulimit me barna per popullsin e aktive dhe jo aktive | 7,400,000 | 1,570,508 | plotesisht |
| Mbulimi i Kujdesit Shendetesor Paresor | 7,478,000 | 1,666,268 | plotesisht |

| | | | |
|---|---------|---------|------------|
| Rikonstruksione te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor) | 50,000 | 0 | aspak |
| Ndertime te reja te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor) | 50,000 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje mjeksore Grupi I | 9,150 | 0 | aspak |
| Blerje Pajisje laboratorike klinike per qendrat shendetesore dhe poliklinikat e Tiranës | 1,000 | 0 | aspak |
| Funksionimi i Klinikës Qeveritare | 21,100 | 5,271 | Plotesisht |
| Funksionimi i Klinikës Stomatologjike Universitare | 49,200 | 8,992 | Plotesisht |
| Projekti i koperacionit italian per ndertimin e dy poliklinikave (TVSH) | 102,602 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje mjeksore Gr2 (koperacioni italian) | 127,800 | 0 | aspak |
| Projekti modernizimit te sistemit shendetesor (Banka Boterore) | 300,410 | 0 | aspak |
| Trajtimi i pacienteve ne spitalin e Durresit | 685,000 | 179,000 | Plotesisht |
| Ndertime e rikonstruksione per godinat e Kujdesit Shendetesor Paresor | 26.889 | 4.577 | pjeserisht |
| Pajisje mobilimi, teknologjike, elektrike per godinat e KSHP | 1.340 | 0 | Aspak |
| Ndertimi i qendrave shendetesore dhe ambulancave nga Gjysem Hena e Kuqe | 103,000 | 2.000 | pjeserisht |

Per periudhen e tre mujorit te pare te vitit 2012, per te gjitha investimet me burim financimi i brendshem per kete program jane ne proces, procedurat e prokurimit. Eshte realizuar procedura e prokurimit per objektin e programit te informatizimit ASTRAIA ne ASHR, por qe ende nuk ka filluar financimi. Nje vlere te konsiderueshme ne kete program ze “Ndertimi dhe rikonstruksioni i QSH-ve dhe Ambulancave ne kuader te Fondit te Zhvillimit te Rajoneve” dhe perkatesisht 100milion leke. Deri tani

eshte kryer vetem alokimi i fondeve per objektet ne vazhdim nga FZHR e v.2011 , te cilat kapin vleren ne total 46.682.297 leke, te cilat jane parashikuar per t'u likujduar ne periudhen maj-qershor v.2012. Diferenca prej 53.317.703 leke eshte parashikuar te shkoje per objektet e reja te ketij viti, si ndertime te reja ashtu dhe rikonstruksione te qsh-ve dhe ambulancave. Pra kjo eshte arsyeja e raportimit "aspak" te ketij produkti.

3. Programi Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

6). Plotesimi ne masen 100% krahasuar me 35% qe eshte aktualisht te sistemeve te informacionit klinik dhe financiar ne spitalet rajonale dhe universitare

- Mbulim 84% I nevojës për shërbim spitalor në vitin 2012 krahasuar me 82% që janë plotësuar në 2011
- Plotesim 70% i nevojave të spitaleve të distriktit me pajisjet e domosdoshme për shërbimin e imazherisë në vitin 2011, referuar 65% që plotësohen aktualisht
- Plotesim në masen 50% i nevojave për pajisje që trajtojnë mbetejet spitalore në spitalet rajonale nga 40% në vitin 2011.
- Plotesim në masen 100% i nevojave baze të urgjencave të spitaleve rajonale dhe urgjencës pediatrike të Tiranës krahasuar me 50% të plotësuar në vitin 2010
- Centralizimi i perpunimit të gjakut në 3 rajone nga 1 që ofrohet në 2011
- Plotesimi në masen 100% krahasuar me 35% që është aktualisht të sistemeve të informacionit klinik dhe financiar në spitalet rajonale dhe universitare.
- Plotesim në masen 70% të nevojave të spitaleve me infrastrukture ndërtimore në vitin 2012 krahasuar me 65% që janë në vitin 2011.

Realizimi i shpenzimeve të tremujorit të parë për këtë program përben 42% të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si më poshtë:

Shpenzime korente 23%

Shpenzime kapitale 31%

Në këtë program janë parashikuar të realizohen produktet e mëposhteme, ecuria e të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

| | Buxheti | Fakti | Statusi I realizimit |
|---|----------------|--------------|-----------------------------|
| Emri i Produktit | 2012 | 2012 | |
| Trajtimi i pacienteve te shtruar ne spitale | 13,371,000 | 3,054,011 | plotesisht |
| Mbulimi financiar i sherbimeve ne spitalet psikiatrike | 541,250 | 129,094 | plotesisht |
| Funksionimi i institucioneve kombetare | 596,542 | 143,330 | plotesisht |
| Nderhyrje e CEB per rikonstruksionin e djegie plastikes | 16,600 | 0 | aspak |
| Furnizimi me rezonance dhe skaner (kredia austriake) | 515,200 | 486.570 | plotesisht |
| Furnizimi me pajisje mjekesore per neurokirurgjine (kredia austriake) | 264,334 | 19.455 | pjeserisht |
| Projekti per rehabilitimin e Spitalit Shkoder Faza III (CEB) | 146,000 | 39.043 | pjeserisht |
| Blerje pajisje te medha dhe komplekse Grupi I (CT Scanera) | 120,000 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje mobilimi, kompjuterike, elektrike , teknologjike, mobilimi | 67,235 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje mjekesore te ndryshme per lab e spitaleve | 129,251 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje mjekesore GrupiII | 257,928 | 0 | aspak |
| Ndertime e rikonstruksione te ambjenteve | 391,228 | 41.682 | pjeserisht |

Ne kete program per tre mujorin e pare te vitit 2012 kemi nje realizim prej 29% te fondeve, ku futen objektet ne vazhdim nga viti 2011, si dhe ecuria e mire e kredive austriake,ku per tu permendur vlen realizimi i instalimit dhe venies ne pune te tre rezonancave dhe 6 CT Scanerave.

Persa i perket “Blerje pajisje te medha dhe komplekse Grupi I(CT Scanera)” jane parashikuar te blihen tre scanera per spitalet rajonale. Jemi ne fazen e lidhjes se kontrates me fituesin, por qe financimi do te kryhet kur te vihen ne pune keto tre pajisje. Jane duke u kryer projekt-preventivat e zbatimit qe do te percaktojne koston e investimit qe do te duhet per venien ne dispozicion te ambienteve ku do te instalohen keto pajisje.

Rreth 240 milion leke jane perqendruar per t'u tenderuar ne aparatin e Ministrise se Shendetesise per pajisje te ndryshme mjekesore, aparatura, si ECHO per sherbime te ndryshme, unit dentar, sterilizator, pasjie per labororet e spitaleve, etj. Ne kete shifer qe permendem nje pjese te konsiderueshme zene investimet ne pajisje shendetesore per sherbime te ndryshme ne QSUT. Per te gjitha keto investime, procedurat jane shpallur ne prill dhe pritet te jepet nje rezultat e procedures ne maj te vitit 2012.

Ne zerin "Ndertime dhe rikonstruksione te ambienteve te sherbimit spitalor", kane filluar financimet per objektet ne vazhdim nga viti 2011. Disa nderhyrje te rendesishme ne kete produkt jane:

1. "Programi i Informatizimit te te gjitha te dhenave –ASTRAIA)" per spitalin e Duresit, Korces dhe Materniteti 1 Tirane me vlere totale 63.775.000 leke. Jane realizuar procedurat dhe financimi do te kryhet ne periudhen prill-maj v.2012.
2. "Ndertimi i godines se administrates dhe QFR ne SUSM Shefqet Ndroqi" me vlere te alokuar per kete vit 100milion leke. Eshte realizuar procedura e prokurimit dhe lidhur kontrata me vlere 239.852.694 leke. Punimet do te fillojne ne momentin e lidhjes se kontrates me fituesin qe do te dale nga procedura e prokurimit per sherbimin e mbikqyrjes se punimeve.
3. "Ndertimi i godines per instalimin e akseleratorit linear te Neurokirurgjise dhe rikonstruksioni i neurologjise ne QSUT", me vlere te alokuar per kete vit 49milion leke. Eshte realizuar procedura e prokurimit dhe lidhur kontrata me vlere 261.889.998 leke. Punimet do te fillojne ne momentin e lidhjes se kontrates me fituesin qe do te dale nga procedura e prokurimit per sherbimin e mbikqyrjes se punimeve.

4. Programi sherbime te shendetit publik

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Mbajtja e nivelit te mbuleses vaksinale te vaksines se re te pneumokokut, ne masen 95% krahasuar me 0% qe ishte ne vitin 2010.
- Sigurimi i qendrueshmerise se mbuleses vaksinale per vaksinat e kalendarit te vaksimit ne masen 95%.
- Reduktimi i numrit te shperthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit ne jo me shume se 3 ne vit ne vitin 2012, krahasuar me mesatarisht 4 ne periudhen 2005-2009
- Monitorimi i agjenteve mjedisore ne vitin 2012 me 2500 inspektime te shoqeruara me masa administrative krahasuar me 2300 inspektime ne vitin .

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 5.3% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

| | |
|--------------------|-----|
| Shpenzime korente | 20% |
| Shpenzime kapitale | 11% |

Ne kete program jane parashikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Ne mije leke

| | Buxheti | Fakti | Statusi I realizimit |
|--|----------------|--------------|-----------------------------|
| Emri i Produktit | 2012 | 2012 | 3 mujori |
| Blerja e montorimi i vaksinave | 247,000 | 0 | aspak |
| Monitorimi i agjenteve mjedisore per ujrat , mjedisin, ushqyerjen, shendetin ne pune,duke respektuar standartet e BE-se. | 2,220,989 | 488,717 | plotesisht |
| Ndert e rikonst te ambjenteve | 17,621 | 3.243 | pjeserisht |
| Bl. Pajisje te reja per laboratoret e shendetit publik | 13,247 | 0 | aspak |
| Blerje pajisje kompjuterike , elektrike , teknologjike | 2,712 | 298 | pjeserisht |

Per “Blerjen e montorimin e vaksinave” vaksinat kane ardhur dhe jemi ne proces likujdimi.

Per kete program ne produktin “Ndertime dhe rikonstruksione te ambienteve” kane filluar likujdimet e objekteve ne vazhdim nga vitit 2011. Per objektet e reja jane duke u kryer procedurat e prokurimit. Persa i perket produktit “Blerje pajisje te reja per lab e shendetit Publik”, te gjitha objektet e investimit jane te perqendruar ne Ministri te Shendetesise persa i perket procedures se prokurimit, qe pritet te perfundoje ne maj te v.2012.

**Relacion mbi gjendjen e zbatimit të projekteve me financim të huaj . 3 mujori i
pare 2012**

Si më poshtë gjeni informacion të detajuar sipas seclit prej projekteve.

1. Per **“Ndertimin dhe Blerje Pajisje Mjekesore per 5 poliklinikat”** (Koperacioni Italian). Disbursimi ne vleren 0 (000/lek)

Per peridhen 3 mujori i pare 2012, gjendja ka ndryshuar. Specialistet italian asistojne ne periudhen paraprake te tenderimit. Pritet konfirmimi i Ministrise se Puneve te Jashtme te Italise per arritjen e tenderimit, fillimisht per paisjet mjekesore per poliklinikat e rikonstruktura ne (Tirane, Korce) dhe me pas per ristrukturimin e poliklinikes ne Gjirokaster dhe Peshkopi.

2. Per **“Modernizimi Sistemit Shendetesor”** (Banka Boterore). Disbursimi ne vleren 0 (000/lek)

Ne kuader te projektit eshte realizuar tenderi per 3 LOTE kryesore te **IT/ PAISJE** ne sherbim te ISKSH & Qendrave Shendetesore.

Eshte realizuar LOTI 2 & 3. Paisjet me nje vlere 780.000 euro kane ardhur por nuk eshte realizuar disbursimi i vleres se lartpermendur. Pritet te realizohet ardhja e paisjeve per LOTI 1.

3. Per **“Ndertime, rikonstruksione & paisje te qendrave shendetesore dhe ambulancave”** (Gjysme Hena e Kuqe). Disbursimi ne vleren 2.000.000 (/lek)

Ka perfunduar se ndertuari ambulance Tip_A2, ne fshatin Lumth, komuna Kolonje-Lushnje. Pritet kompletimi me paisjeve mjekesore per objektet qe do te ndertohen brenda muajit qershor 2012.

4. Per **“Blerje pajisje mjekesore komplekse per spitalet rajonale”** (kredia austriake) Disbursimi ne vleren 486,570 (000/lek)

Projekti ka perfunduar 100%. Jane instaluar e vene ne pune te gjitha aparaturat (rezonancat dhe skanerat) ne 6 spitalet rajonale.

5. Per **“Blerje pajisje mjekesore per neurokirurgjine”** (kredise austriake). Disbursuar 0 (000/lek).

Gjate tremujorit te pare te ketij viti nuk ka asnje lloj aktiviteti. Mbetet per te ardhur paisja mjekesore LINAK

6. Per **“Blerje pajisje mjekesore per onkologjine”**, jemi ne fazat e negociatave me palen austriake per shumen e kredise qe do te mundesoje keto blerje

7. Per **“Informatizimit te sistemit shendetesor IT-HEALTH”** (Kredi Austriake)

Jemi ne fazat e negociatave me palen Austriake.